



UK Health
Security
Agency



Mbrojtja nga lija e majmunit

Informacion lidhur me vaksinimin kundër lisë së majmunit

Çfarë është vaksinimi kundër lisë së majmunit (MVA)?

Ju ofrohet një vaksinë për t'ju ndihmuar të mbroheni nga lija e majmunit. Vaksina MVA ndihmon në parandalimin ose reduktimin e shkallës së infeksionit të lisë së majmunit (dhe lisë).

Vaksina prodhohet në Evropë nga Bavarian Nordic. Kur ju jepet vaksina, sistemi juaj imunitar (sistemi mbrojtës natyror i trupit) prodhon antitrupa kundër virusit të lisë së majmunit.

Vaksina MVA nuk përmban virusin e lisë apo të lisë së majmunit, ndaj nuk mund të përhapet ose të shkaktojë linë apo linë e majmunit.

Vaksina Imvanex është autorizuar nga Agjencia Rregullatore e Barnave dhe Produkteve Shëndetësore (Medicines and Healthcare products Regulatory Agency, MHRA) e Mbretërisë së Bashkuar për t'u mbrojtur nga lia dhe lia e majmunit.

Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar (UK Health Security Agency, UKHSA) dhe Komiteti i Përbashkët për Vaksinimin dhe Imunizimin (Joint Committee on Vaccination and Immunisation, JCVI) rekomandojnë përdorimin e vaksinës MVA si pjesë e reagimit ndaj rasteve të lisë së majmunit.

Lia e majmunit, (i njohur ndryshe si “mpox”), është një sëmundje e rëndë infektive që mund të shfaqet në formën e plagëve të dhimbshme të lëkurës. Këto mund të shfaqen në çdo pjesë të trupit:



Çfarë është liza e majmunit?

Liza e majmunit është një infeksion i rrallë që gjendet më shpesh në Afrikën Qendrore dhe Lindore.

Infeksioni mund të merret nga:

- çdo kontakt i ngushtë fizik me flluskat e lisë së majmunit ose zgjebes (duke përfshirë gjatë kontaktit seksual, puthjes, përqaimit ose prekjes së duarve);
- prekja e rrobave, çarçafëve ose peshqirëve që i ka përdorur dikush që është i infektuar me linë e majmunit;
- kontakti me lëngjet trupore si pështyma, gëlba ose mukozë.

Zakonisht, liza e majmunit është zakonisht e lehtë dhe mund të përmirësohet brenda disa javësh pa trajtim. Por nëse simptomat tuaja janë të rënda dhe nuk jeni mirë, do t'ju duhet trajtim në spital.

Për kë rekomandohet MVA?

UKHSA aktualisht rekomandon që MVA të ofrohet për:

- ✓ **Punonjësit e kujdesit shëndetësor që kujdesen dhe që duhet të fillojnë të kujdesen për një pacient të konfirmuar me linë e majmunit**
- ✓ **Personat gej, biseksualë dhe burrat që bëjnë seks me burrat.** Mjeku do t'ju këshillojë të bëni vaksinën nëse keni më shumë se një partner, nëse bëni seks në grup ose nëse shkoni në vende "seks në ambiente"
- ✓ **Njerëzit që kanë pasur tashmë kontakt të ngushtë me një pacient të konfirmuar me linë e majmunit.** Vaksinimi me një dozë të vetme vaksine duhet të ofrohet sa më shpejt që të jetë e mundur (idealisht brenda 4 ditëve, por ndonjëherë deri në 14 ditë)
- ✓ **Njerëzit që bëjnë pjesë në një grup ose që shkojnë në një vend ku ka një rast ose përhapje të lisë, ose ku disa nga pjesëtarë kanë pasur kontakt të ngushtë me një rast.**

A funksionon vakcina?

Është provuar se dy doza të vaksinës japin një nivel të lartë mbrojtjeje kundër lisë së majmunit. Mbrojtja është gjithashtu shumë e mirë pas dozës së parë, por ndonjëherë këshillohet një dozë e dytë për mbrojtje afatgjatë.

Vaksina mund të mos parandalojë plotësisht infeksionin, por edhe nëse infektoheni me linë e majmunit, simptomat nuk duhet të jenë aq të rënda.

Doza e parë e përgatit sistemin tuaj imunitar që të reagojmë shumë më shpejt nëse bini në kontakt me linë e majmunit.

Vaksina ka nevojë gjithashtu për kohë që të veprojë. Mund të fillojë të funksionojë pas disa ditësh dhe duhet të arrijë mbrojtjen më të lartë për rreth 4 javë.

Doza e dytë mund të jepet pas 28 ditësh, megjithatë mund të jepet edhe shumë më vonë, edhe pas disa muajsh. Kur koha midis dozës së parë dhe dozës së dytë është më e gjatë, mbrojtja do të zgjatë më shumë.

Edhe pas 2 dozave duhet të vazhdoni të jeni të vetëdijshëm për rreziqet dhe simptomat e lisë së majmunit. Nëse keni simptoma, qëndroni në shtëpi dhe telefononi 111 ose një klinikë të shëndetit seksual.

A shkakton vakcina ndonjë efekt anësor?

Vaksina ka një profil shumë të mirë sigurie. Njëlloj të gjitha mjekimet dhe vaksinat e tjera, ajo mund të shkaktojë efekte anësore, por shumica e tyre janë të lehta dhe afatshkurtra, megjithëse jo të gjithë i kanë. Ndryshe nga vakcina e vjetër e lisë, vaksinimi nuk lë shenjë.

Efektet anësore mund të jenë më të shpeshta te njerëzit që kanë bërë më parë një dozë të vaksinës së gjallë kundër lisë. Këta njerëz kanë nevojë vetëm për një dozë MVA për të rritur mbrojtjen e tyre ekzistuese.

Efektet anësore të zakonshme përfshijnë dhimbje dhe kruajtje në vendin e injektimit dhe dhimbje koke, dhimbje muskulore, sëmundje dhe lodhje. Rreth 1 në 10 persona ka të dridhura dhe temperaturë, por këto nuk duhet të zgjasin më shumë se disa ditë.

Nëse përjetoni ndonjë nga efektet anësore të përmendura më sipër, duhet të pushoni, dhe mund të merrni dozën e duhur të paracetamolit për të ndihmuar në lehtësimin e simptomave.

Nëse tashmë keni dermatit atopik (një formë ekzeme), mund të përjetoni reaksione lokale më intensive të lëkurës (si skuqje, ënjtje dhe kruajtje) dhe simptoma të tjera të përgjithshme (si dhimbje koke, dhimbje muskujsh, ndjesi sëmurë ose të lodhur), si dhe një acarim ose përkeqësim të gjendjes së lëkurës.

A ka njerëz që nuk duhet ta bëjnë vaksinën MVA?

Të vetmit njerëz që nuk duhet ta bëjnë vaksinën janë ata që kanë pësuar më parë një reaksion alergjik të papritur kërcënues për jetën ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose ndaj ndonjë përbërësi të vaksinës. Vaksina përmban sasi të vogla të proteinave të pulës, benzonazës dhe gentamicinës dhe ciprofloksacinës (antibiotikë).

Cilët persona është mirë që ta shtyjnë kryerjen e vaksinës?

Nëse jeni të sëmurë me temperaturë të lartë, mund të jetë e nevojshme t'ju bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse keni shenjat e para të lisë së majmunit. Nëse sëmundja juaj nuk lidhet me linë e majmunit, mund t'ju ofrohet vaksina. Prania e një infeksioni të vogël, siç është ftohja, nuk duhet të kërkojë shtyrjen e vaksinimit, por flisni në fillim me mjekun ose infermieren tuaj.

Kush tjetër duhet të ketë kujdes të veçantë?

Duhet t'i tregoni mjekut ose infermieres nëse keni bërë vaksinë kundër lisë në të kaluarën ose nëse keni dermatit atopik, pasi rreziku i efekteve anësore nga vaksina MVA mund të jetë më i lartë.

Nëse jeni pozitiv me HIV ose nëse keni ndonjë problem shëndetësor ose po ndiqni ndonjë trajtim tjetër i cili shkakton dobësim të sistemit imunitar, vaksina mund të mos ju mbrojë aq mirë. Njoftoni mjekun ose infermieren tuaj.

Po mjekimet e tjera që marr?

Tregojini mjekut ose infermieres tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit ndonjë mjekim tjetër ose nëse keni bërë kohët e fundit ndonjë vaksinë tjetër. Në shumicën e rasteve, nuk duhet të jetë problem për të bërë vaksinën.

Vaksina mund t'u bëhet në mënyrë të sigurt njerëzve që janë të infektuar me HIV, atyre që marrin PreP. Gjithashtu mund të bëhet në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera të rëndësishme, duke përfshirë ato kundër HPV dhe viruseve të hepatitit A dhe hepatitit B.

Si jepet MVA?

Ekzistojnë dy metoda që përdoren për të kryer injeksionin MVA, mundësisht në pjesën e sipërme të krahut. Në një nga metodat, injektimi bëhet poshtë lëkurës ose në muskul (e ngjashme me shumicën e vaksinave të tjera), në metodën tjetër injektimi bëhet në lëkurë, si vaksina BCG kundër TB. Të dyja metodat janë shumë të efektshme.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive:

Nuk ka asnjë arsye për të besuar se vaksina do të ndikojë tek aftësia juaj për të drejtuar automjetin ose për të përdorur makineri. Ndodh shpesh një gjendje të fikëti pas vaksinimit, ndaj mund t'ju duhet të prisni 15 minuta pas gjilpërës para se të lejoheni të drejtoni automjetin.

Regjistrimi i vaksinimit kundër lisë së majmunit

Regjistroni më poshtë datën ose datat e vaksinimit kundër lisë së majmunit në mënyrë që të mos e lini pas dore mbrojtjen.

Mos harroni, që të jeni të mbrojtur, duhet të përfundoni kursin e plotë të vaksinës:

Mpox (MVA-BN) Doza e vaksinës	Data
Doza 1	
Doza 2 Të paktën 28 ditë pas dozës së parë	

Çfarë duhet të bëj tani?

Pyesni infermieren ose mjekun e klinikës për më shumë hollësi. Vaksina është e disponueshme në shërbimet e specializuara të shëndetit seksual (SHS).


Për më shumë informacion rreth lisë së majmunit dhe ku mund të gjeni një vend për kryerjen e vaksinës, vizitoni:

www.nhs.uk/conditions/mpox/find-a-mpox-vaccination-site

Efekte anësore të rënda

Disa probleme shëndetësore të tjera janë raportuar më rrallë se njerëzit që kanë bërë vaksinën. Për të qenë të sigurtë, në shtojcën e produktit të vaksinës përmenden të gjitha këto probleme shëndetësore – edhe ato të raportuara në raste të veçanta – por kjo nuk do të thotë medoemos që ishte faji i vaksinës. Nëse keni ndonjë efekt anësor, flisni me mjekun, farmacistin ose infermieren tuaj. Këtu përfshihet çdo efekt anësor të mundshëm që nuk përmendet në këtë fletushkë.


Duke raportuar efektet anësore, ju mund të ndihmoni në sigurimin e informacioneve të mëtejshme lidhur me sigurinë e kësaj vaksine.



Ju lutemi të raportoni çdo efekt anësor të dyshuar drejtpërdrejt përmes skemës Yellow Card në faqen e internetit:

yellowcard.mhra.gov.uk,

duke shkarkuar aplikacionin Yellow Card ose duke telefonuar skemën Yellow Card në 0800 731 6789 09:00 – 17:00.



Do të merrni më shumë informacion lidhur me këtë mjekim në shtojcën e paketimit që mjeku ose infermiera duhet t'ju japë.

Shtojca mund të gjendet gjithashtu në faqen e internetit të Agjencisë Evropiane të Barnave:

www.ema.europa/en/medicines/human/EPAR/Imvanex

